



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.116

18 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.519, datë 20.7.2011

Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të
planit të veprimit të saj

4579

VENDIM
Nr.519, datë 20.7.2011

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË DHE TË
PLANIT TË VEPRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministritë e linjës dhe institucionet e drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

HYRJE

Ky dokument prezanton Strategjinë ndërsektoriale të sistemit të drejtësisë, që synon përsosjen më tej të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare paralelisht me forcimin dhe rritjen më tej të kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe nxitjen e përshejtimin e integritimit europian.

Kjo strategji bazohet në politikat ekzistuese të Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Europian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe si Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2007-2013, Plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Opinioni 2010 i Komisionit Europian mbi kërkesën e Shqipërisë për statusin e vendit kandidat. Ajo merr në konsideratë edhe faktin që për çështje apo fusha të caktuara veprojnë strategji të veçanta si Strategjia antikorrupsion, ajo për arsimin e lartë apo ajo për Policinë e Shtetit. Strategjia merr në analizë çështjet e identifikuara të sistemit të drejtësisë, si dhe ato të ngritura përgjatë procesit konsultativ të saj. Gjithashtu, ky dokument strategjik pritet të kontribuojë edhe me gjerë, përtej sektorit të drejtësisë, si një mjet efektiv në duart e politikëbërësve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në procese të lidhura me sistemin e drejtësisë.

Objektivi i hartuesve të këtij dokumenti është që politikat e evidentuara në këtë dokument të kontribuojnë në promovimin e bashkëpunimit me partnerët brenda dhe përtej sistemit të drejtësisë, dhe aty ku është e mundur edhe me aktorë ndërqeveritarë, me qëllim hartimin e politikave dhe planeve të mëtejshme e me bazë më të gjerë.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri aktualisht përfshin një numër institucionesh dhe organizatash:

- Gjykatat;
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
- Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor;
- Konferenca Gjyqësore Kombëtare;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Prokuroria dhe shërbimet e policisë gjyqësore;
- Ministria e Drejtësisë;

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Shërbimi i Provës;
- Sistemi i Përmbartimit Gjyqësor;
- Qendra e Publikimeve Zyrtare;
- Komiteti Shqiptar i Birësimeve;
- Avokatura e Shtetit;
- Instituti i Mjekësisë Ligjore;
- Profesionet e lira.

Këto organizma veprojnë brenda një kuadri rregullash kushtetues dhe ligjorë, që përcakton jo vetëm kompetencat e tyre, por edhe kufijtë ndarës dhe rastet e bashkëveprimit institucional midis tyre në funksion të dhënies dhe zbatimit të drejtësisë.

Në themel të analizës së këtij dokumenti strategjik është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sistemit të drejtësisë, të ofruara përkundrejt kostove efektive. Shërbimet e këtij sistemi duhet të jenë të orientuara për të përmbushur me cilësi, shpejtësi dhe efektivitet nevojat e përdoruesve dhe të komunitetit. Nga ana tjetër, një sistem efektiv drejtësie nuk kontribuon vetëm në mirëqenien ekonomike të një vendi, por synon ta zhvillojë shoqërinë e vet duke siguruar që shteti i së drejtës funksionon siç duhet në të. Planifikimi i zbatimit të politikave mbështetëse, gjithashtu, në kontekstin dhe mundësitë ekzistuese financiare, duke konkluduar në përcaktimin e prioritetëve të prekshme dhe të nevojshme. Rrjedhimisht, edhe për këtë shkak ky dokument pritet të shndërrohet në një mjet realist, praktik dhe të kuptueshëm për t'u zbatuar.

Strategjia e analizon funksionin e dhënies dhe zbatimit të drejtësisë nga dy këndvështrime themelore:

- i) nga këndvështrimi i operatorit që ushtron funksionin (ofruesi i shërbimit); dhe
- ii) nga këndvështrimi i marrësit të shërbimit (përfituesi)

Rrjedhimisht parimet që përshkojnë këtë strategji janë:

- pavarësia;
- paanësia;
- përgjegjshmëria ndaj Kushtetutës dhe ligjit;
- aksesin në drejtësi;
- transparencën; dhe
- cilësinë e shërbimit përkundrejt kostos efektive.

Strategjia sektoriale e drejtësisë përcakton këtë vizion për sistemin e drejtësisë: “Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike si një shtet i së drejtës, demokratik dhe garant i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo”. Ky dokument strategjik synon të reflektojë hapat që duhen ndërmarrë në procesin integruar të vendit në Bashkimin Europian. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian e vendeve anëtare të tij bën të detyrueshme qasjen europiane të të gjithë sektorëve të strategjisë. Kjo shoqërohet edhe me nevojën në rritje për trajnimin e operatorëve të sistemit të drejtësisë mbi legjislacionin europian, si dhe me praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Në këtë proces sfidat aktuale të sistemit të drejtësisë, në shërbim edhe të rritjes së besimit të publikut, mbeten:

- Mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor, jo vetëm për përafrimin e legjislacionit me *acquis communitaire* dhe praktikën e mira, por mbi të gjitha për zbatimin efektiv të legjislacionit të miratuar, duke i shndërruar procedurat gjyqësore në eficientë dhe të shpejta, duke evituar vonesat në gjykim dhe ulur çështjet e prapambetura;
- Të drejtat e njeriut, sidomos të drejtat e kategorive vulnerabël, siç janë të burgosurit dhe të paraburgosurit, për zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, të humanizmit, të sigurisë juridike për to dhe harmonizimi i legjislacionit respektiv; aksesin në drejtësi në funksion të procesit të rregullt ligjor, rritja e rasteve për mbrojtje të detyrueshme, përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes dhe evitimi i taktikave vonuese të mbrojtësve në proceset gjyqësore;

- Bashkëpunimi ndërkombëtar, si premisë bazë për proceset integruese që po kalon vendi.

Realizimi i vizonit strategjik do të arrihet nëpërmjet zbatimit të objektivave konkrete të përcaktuar në përmbajtje të dokumentit, të tilla si: zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve; qeverisje e mirë, luftë ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimin e vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës; pavarësi, transparencë, përgjegjshmëri dhe efikasitet në funksionimin e sistemit të drejtësisë; zbatimi i ligjit dhe mbarëvajtje e reformës në drejtësi; harmonizim të legjislacionit të sistemit të drejtësisë; bashkëpunim ndërinstitucional midis institucioneve të ndryshme të gjyqësorit.

Në zbatim të urdhrin nr.134, datë 12.6.2006 të Kryeministrit “Për përgatitjen dhe hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim”, në Ministrinë e Drejtësisë është punuar për draftstrategjinë në përputhje me kriteret dhe metodikën e përcaktuar në manualin për përgatitjen e strategjive kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale. Strategjia e hartuar është e ndarë në kapituj, të cilët përmbajnë:

1. Kushtet aktuale dhe analiza ligjore dhe institucionale;
2. Vizionin, prioritetet dhe qëllimet strategjike;
3. Politikat;
4. Rrjedhojat për burimet;
5. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese.

Së fundmi, duhet vënë në dukje se zhvillimi i kësaj strategjie u mbështet në përfshirjen e gjerë të të gjitha organeve të drejtësisë, si dhe të organizatave ndërkombëtare të interesuar, sidomos të Komisionit European, Misionit Euroalians III, OSBE, Këshilli i Europës.

KAPITULLI I ASPEKTE LIGJORE DHE KUSHTET AKTUALE

A. ASPEKTE LIGJORE

1. Pushteti gjyqësor

1.1 Gjykatat

Të drejtat e qytetarëve janë të garantuara në legjislacionin shqiptar, me anë të rregullave që disjplinojnë procedurat dhe masat që ndërmerren në rastin e shkeljes së tyre. Qytetari në rastin e shkeljes së të drejtave të tij nga autoritetet publike ezauron hap pas hapi procesin administrativ të kundërshtimit të shkeljes së evidentuar. Pas ezaurimit të rekursit administrativ, qytetari i drejtohet gjykatës, si hallkë të fundit të rivendosjes së të drejtës së shkelur. Rishikimi gjyqësor i akteve administrative përbën një garanci kushtetuese për qytetarin për mbrojtjen e të drejtave të tij nëpërmjet gjykimit të drejtë, publik, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për mosmarrëveshjet e natyrës private, qytetari i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës, e cila ka për detyrë të realizojë një proces të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shkelura, si dhe të ndihmojë për forcimin e rendit juridik. Gjithashtu, qytetari i drejtohet, sipas rastit, prokurorisë ose drejtpërdrejt gjykatës, kur dëmtohet nga vepra penale, duke kallëzuar veprën penale apo duke kërkuar procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.

Në Republikën e Shqipërisë, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat që u ngarkohen atyre me ligj. Organizimi i gjykatave mbështetet në Kushtetutë dhe në ligjin nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave, drejtimin dhe organizimin e shërbimeve ndihmëse, si dhe kompetencat e kancelarit të gjykatës.

Si autoriteti më i lartë gjyqësor, parashikohet Gjykata e Lartë, e cila ushtron juridiksion fillestar dhe rishikues. Organizimi dhe funksionimi rregullohet në detaje nga ligji nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Gjykata e Lartë është organ kushtetues dhe gjykata më e lartë e sistemit gjyqësor në vend. Gjykata e Lartë përbëhet nga 17 gjyqtarë dhe organizohet në Kolegjin Civil dhe Kolegjin Penal.

1.2 Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)

Ligji nr.8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” ka përcaktuar KLD-në si autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. KLD-ja, përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë e kryesohet nga Presidenti i Republikës.

KLD-ja:

1. Dërgon propozimin drejtuar Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit.

2. Bën transferimin e gjyqtarëve, duke respektuar kriterin se transferimi i gjyqtarëve bëhet vetëm me pëlqimin e tyre, me përjashtim të rasteve të riorganizimit të pushtetit gjyqësor.

3. Bën emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit.

4. Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe kontrollin e të gjithë procesit të vlerësimit.

5. Miraton masat disiplinore për gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit kur nga ana e tyre kryhen shkelje shumë të rënda të disiplinës të parashikuara në ligj.

6. Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve duke i dhënë mendim Shkollës së Magjistraturës, për programin e formimit vazhdues.

1.3 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ)

Në kuadër të garantimit të pavarësisë së veprimtarisë së organeve gjyqësore, Kushtetuta (neni 144) dhe ligji nr.8363, datë 1.7.1998 kanë parashikuar pavarësinë financiare të gjyqësorit. Për këtë arsye, me ligj është krijuar ZABGJ-ja, si një institucion i pavarur që administron fondet buxhetore të akorduara për sistemin gjyqësor, duke siguruar zbatimin në parim të pavarësisë së tij nga pushtetet e tjera.

1.4 Konferenca Gjyqësore Kombëtare (KGJK)

Kushtetuta parashikon organizimin e KGJK-së me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të të gjitha niveleve, nga e cila zgjidhen 9 anëtarët e KLD-së. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.25/2008, shfuqizoi ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”, për defekte të procedurës parlamentare në miratimin e tij. KGJK-ja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e performancës së gjyqësorit.

1.5 Shkolla e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë është një institucion me pavarësi institucionale, akademike dhe administrative, e krijuar me ligjin nr.8136/1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar. Shkolla e Magjistraturës është e vendosur në Tiranë dhe drejtohet nga Këshilli Drejtues i saj.

Arsimi i lartë juridik në Shqipëri i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë janë: universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare. Sistemi arsimor realizohet me ligj; ai përbëhet nga rrjeti i institucioneve publike dhe private. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka miratuar vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1509, datë 30.7.2008 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin e lartë, 2008-2013”, që përbën një dokument politikash, ku përcaktohen prioritetet strategjike dhe masat konkrete të veprimit mbi organizimin dhe funksionimin efektiv të sistemit arsimor të lartë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri, sikurse përcakton procesi i Bolonjës. Kjo strategji parashtron zhvillimet e politikave afatmesme dhe afatgjata si për sistemin, ashtu edhe çdo institucion të arsimit të lartë publik dhe privat duke pasqyruar vizionin e Qeverisë në sferën e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe arsimin juridik.

Shkolla e Magjistraturës siguron formimin profesional fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe formimin profesional vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

2. Organet e ndjekjes penale

2.1 Prokuroria

Kushtetuta përcakton se misioni i Prokurorisë është ushtrimi i ndjekjes penale, përfaqësimi i akuzës në gjyq në emër të shtetit, si dhe kryerja e detyrave të tjera të caktuara me ligj. Prokuroria

organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr.8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar. Njëkohësisht në bazë të ligjit nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, janë krijuar prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

2.2 Policia Gjyqësore

Kodi i Procedurës Penale parashikon si subjekt të ndjekjes penale policinë gjyqësore, që ka funksion marrjen dëgjoni për veprat penale, pengimin e ardhjes së pasojave të mëtejshme, kërkimin e autorëve të tyre, kryerjen e hetimeve, si dhe grumbullimin e gjithçkaje që i shërben zbatimit të ligjit penal. Ky funksion nuk kryhet nga një organ i posaçëm, por i atribuohet Policisë së Shtetit, seksioneve e policisë gjyqësore pranë prokurorive të rrethit, si dhe çdo shërbimi policie gjyqësore të parashikuar me ligj. Këto parashikime konfirmohen edhe në ligjin nr.8677/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”¹ dhe nga ligji nr.9749/2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Në kuadër të identifikimit të prioriteteve kryesore për çështje që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë publike, Qeveria Shqiptare ka nxjerrë vendimin nr.14, datë 9.1.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të rendit publik”. Kjo strategji përmban zhvillimet më të rëndësishme të Policisë së Shtetit, duke u përqendruar në realizimin e prioriteteve strategjike të saj dhe zhvillimin e filozofisë së policimit dhe të menaxhimit.

Këto zhvillime do të kenë në thelb përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit duke u orientuar nga nevojat dhe kërkesat e tij, përmirësimin e performancës policore nëpërmjet arritjes së standardeve bashkëkohore dhe përdorimit të teknologjive dhe formave më të përparura. Gjithashtu, Strategjia shoqërohet me planin e veprimit, i cili detajon në masa dhe veprime konkrete prioritetet strategjike të dokumentit. Prioritetet që identifikohen në këtë strategji janë: 1) thellimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; 2) menaxhimi i integruar i kufijve; 3) ndërtimi i partneritetit; 4) përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe ndërtimi i besimit; 5) polici i udhëhequr nga Inteligjenca; 6) reduktim i mëtejshëm i krimit dhe i sjelljes antishoqërore; 7) përmirësimi i menaxhimit në Policinë e Shtetit; 8) rritja e sigurisë rrugore; 9) përmirësim i procesit të menaxhimeve të burimeve njerëzore; 10) përmirësimi i proceseve të administrimit dhe investimeve të ndërtesave të policisë; 11) përmirësimi i proceseve të shërbimeve mbështetëse logjistike dhe 12) përmirësim të sistemit të menaxhimit financiar.

3. Pushteti ekzekutiv

3.1 Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë. Në marrëdhëniet me prokurorinë, Ministria e Drejtësisë ushtron kontroll sipas ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve në çështjet që kanë përfunduar hetimet paraprake. Përveç shumë aktiviteteve, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet strukturave përkatëse punon për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar nëpërmjet zbatimit të akteve ndërkombëtare dhe legjislativitetit shqiptar me qëllim intensifikimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja të drejtësisë, si dhe përkthimin e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Procesi legjislativ në kuadër të reformës në drejtësi realizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me profesionistë, akademikë, juristë, praktikienë, gjyqtarë dhe prokurorë të shquar në sistemin e drejtësisë.

Pjesë e punës është edhe përmbushja e objektivave të parashikuara për luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë, ku nga njëra anë kërkohet konsolidimi i hetimit dhe efikasiteti

¹ I ndryshuar së fundmi me ligjin nr.10 295, datë 1.7.2010 duke përmirësuar rregullat mbi profesionalizmin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të ndjekjes penale

së ndjekjes penale, dhe nga ana tjetër rritja e shpejtësisë së ndjekjes penale dhe gjykimit, të parashikuara këto në Strategjinë ndërsektoriale për parandalimin e Luftës kundër korrupsionit dhe për një qeverisje më transparente, 2008-2013, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1561, datë 3.10.2008.

Mbështetur në aktet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria ka aderuar, si dhe në legjislacionin e brendshëm, do të hartohet, si komplementare e Strategjisë për reformën e drejtësisë dhe në koherencë të plotë me të, një strategji sektoriale e “Drejtësisë për të miturit”, e cila do të adresojë:

i) administrimin e drejtësisë për të miturit (të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale);

ii) të miturit viktime të krimit, dhe

iii) të miturit dëshmitarë.

3.2 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të vuajtjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve dhe të dënuarve me burgim. Monitorimi i situatës bëhet nga Avokatit i Popullit, në kuadrin e përmbushjes së rolit të tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (CPT), i cili kryen inspektime në burgje dhe jep rekomandimet përkatëse, nëpërmjet Njësisë për Parandalimin e Torturës.

3.3 Shërbimi i Provës

Shërbimi i Provës është organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i krijuar në vitin 2009 me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr.8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Ai ka për mision të mbikëqyrë zbatimin e dënimeve alternative, duke paraqitur informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, si dhe të ndihmojë personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Shërbimi i Provës organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë përbën nivelin qendror, ndërsa zyrat vendore të shërbimit të provës veprojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Aktualisht ka vetëm 8 zyra vendore, që ushtrojnë funksionet në të gjithë territorin, me qendra në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Shkodër.

3.4 Shërbimi Përmbarimor

Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat. Sistemi i dyfishtë i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor nënkupton që funksionet që ka Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, të mund të kryhen edhe nga operatorë privatë të certifikuar, për këtë qëllim.

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror organizohet sipas ligjit nr.8730/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” dhe varet nga Ministri i Drejtësisë.

Në nivelin vendor të organizimit, zyrat përmbarimore, pranë çdo rrethi gjyqësor, marrin masat e nevojshme procedurale për ekzekutimin efektiv të titujve ekzekutivë. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat organizohet sipas ligjit nr.10 031/2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” zbatohet për përmbaruesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Përmbaruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbaruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.5 Publikimet zyrtare (QPZ)

Qendra e Publikimeve Zyrtare është institucion qendror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë e krijuar me ligjin nr.8502, datë 30.6.1999 “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, të ndryshuar. Qendra e Publikimeve Zyrtare boton Fletoren Zyrtare dhe indeksin tematik dhe kronologjik të legjislacionit shqiptar, si dhe bën përditësimin e kodeve të Republikës së Shqipërisë.

3.6 Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB)

KSHB-ja është organ kolegjal në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (kodi i Familjes, ligji nr. 9695/2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar dhe ligji nr.9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar). Qëllimi kryesor 4584

është mbrojtja e të miturve nëpërmjet birësimit duke synuar krijimin e një familjeje të re të përhershme për të garantuar dhe respektuar të drejtat themelore të tyre.

3.7 Avokatura e Shtetit

Avokatura e Shtetit është institucion qendror e krijuar me ligjin nr.8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, e reformuar në bashkëpunim me partnerë të huaj (AECID), me ligjin nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”², dhe rregulloren “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”³. Detyra kryesore e Avokaturës së Shtetit është dhënia e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike.

3.8 Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)

Instituti i Mjekësisë Ligjore është krijuar me vendimin nr.120/2003 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ky institut është i centralizuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria në fushën e ekspertimit mjeko-ligjor mbështetet në ligjet nr.7830/1994 “Për autopsitë” dhe nr.7893/1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”. Në nivelin vendor të organizimit në rrethe ekzistojnë ekspertë mjeko ligjorë në qarqe, pranë gjykatave të apelit, ndërsa në rrethe të tjera janë aktivizuar me kontratë si ekspertë mjeko-ligjorë, mjekë ekspertë, anatomopatologë, mjek kirurg etj.

4. Profesionet e lira

Ministria e Drejtësisë sipas parashikimeve të ligjit nr.8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” të ndryshuar, ndjek dhe mbështet, sipas ligjit, ushtrimin e profesionit të:

- avokatit (veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë);
- noterit (veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë);
- arbitrit (veprimtaria e të cilit rregullohet në dispozita ligjore që rregullojnë fusha të caktuara);
- ndërmjetësit (veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë);
- administratorit të falimentit (veprimtaria e të cilit rregullohet në dispozita ligjore që rregullojnë fusha të caktuara);
- ekspertit; dhe
- përkthyesit.

B. KUSHTET AKTUALE

1. Pushteti gjyqësor

1.1 Gjyqësori

Pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor me orientimin e përmirësimit të shtetit ligjor, të rritjes së pavarësisë dhe paanësisë së pushtetit gjyqësor, krahas rritjes së përgjegjshmërisë ndaj ligjit, në praktikë gjyqësori shfaq disa problematika dhe dobësi.

Problematikat e hasura janë:

- Korrupsioni

Sot pushteti gjyqësor konsiderohet si një ndër fushat me nivel të lartë perceptimi korrupsioni nga raportet vlerësuese të organizatave të huaja apo vendase, ankesat e publikut apo denoncimeve të kryera në numrat e gjelbër të vendosura në çdo institucion. Në raportin analitik 2010 të Komisionit European mbi Shqipërinë, gjyqësori paraqitet si një nga fushat me shqetësim në korrupsion, i shkaktuar nga një sërë faktorësh si mungesa e përgjegjshmërisë, transparencës, paanësisë, statusi i gjyqtarëve, duke përfshirë edhe imunitetin e plotë të gjyqtarëve si prej pengesave të hetimit të rasteve korruptive në gjyqësor. Ndonëse ka një tendencë në rritje për luftën institucionale kundër korrupsionit (KLD ka pranuar çdo kërkesë të Prokurorisë për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve në

² miratuar me urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë nr.275/1, datë 14.1.2009

³ miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.392, datë 8.4.2009

rastet e paraqitura⁴) duket se masat parandaluese nuk janë ende të mjaftueshme (për ilustrim shërben imuniteti i plotë i gjyqtarëve).

- Eficienca

Niveli i statusit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, duke përfshirë edhe pagat, ende nuk është në përputhje të plotë me standardet europiane. Aktualisht ka nevojë për një analizë dhe standardizim të të gjitha privilegjeve që gëzojnë gjyqtarët për shkak të detyrës. Garancitë për promovimin në karrierë të gjyqtarëve dhe për procedimin disiplinor të tyre, nuk zbatohen sa duhet në praktikë. Raportet ndërkombëtare referojnë se nuk ka ende një ndarje të qartë të kompetencave të inspektorateve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të KLD-së, paralelisht nevojën për rritjen e transparencës së procedimeve disiplinore duke qenë se kompetencat e secilit parashikohen në ligjin nr.8811/2001 dhe ligjin nr.8678/2001, i ndryshuar.

Vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe krijimi i listës së renditjes së tyre nuk është konsoliduar si proces. Zhvillimi i vullshëm i legjislacionit nxjerr në pah çështje të aftësive profesionale dhe të profilizimit, sepse trajnimet duhet të fokusohen më shumë në zhvillimet e reja të legjislacionit, standardet ndërkombëtare, standardet e procesit të rregullt ligjor, çështjet e etikës, logjikës dhe psikologjisë gjyqësore. Edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë mbeten të papërditësuar me zhvillimet e legjislacionit dhe të doktrinës. Administrata gjyqësore mbështet veprimtarinë e gjykatave, megjithatë ka nevojë në rritje për konsolidimin e standardeve të performancës dhe të statusit të saj. Kushtet fizike të punës janë të tilla që ende lejojnë zhvillimin e gjykimeve në zyrat e gjyqtarëve. Kjo problematikë mbi infrastrukturën (për zyra gjyqtarësh, ndihmësish ligjorë dhe pjesën tjetër të administratës) përshkon edhe Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm paraqiten me transparencë dhe efikasitet të ulët, që shkakton mungesë të dukshme besimi të publikut në të dhe në pavarësinë e paanësinë e tyre. Volumi i çështjeve dhe zvarritjet e gjykimeve përbëjnë një prej shqetësimeve bazë me impakt në cilësinë e drejtësisë dhe të performancës së gjyqtarëve, por edhe në drejtim të standardeve të procesit të rregullt gjyqësor. Statistikat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë japin këtë pamje të kohëzgjatjes së gjykimeve:

KOHËZGJATJA MESATARE NË MUAJ SIPAS GJYKATAVE E ÇËSHTJEVE CIVILE

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009
Rrethi gjyqësor	3.0	3.4	4.4	4.5	4.7
Apeli	6.4	6.4	8.3	10.5	10.5
Gjykata e Lartë	2.7	3.0	3.2	2.7	2.7

KOHËZGJATJA MESATARE NË MUAJ SIPAS GJYKATAVE E ÇËSHTJEVE PENALE

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009
Rrethi gjyqësor	3.4	3.5	3.4	3.5	3.6
Shkalla e Parë për Krime të Rënda	9.8	12.4	12.2	9.3	9.2
Apeli	3.4	3.5	4.2	4.5	5.4
Apeli për Krime të Rënda	2	2.8	2.8	2.5	1.9

Legjislacioni procedural është duke u ndryshuar vullshëm, për t'u përqasur jo vetëm me standardet europiane, por edhe për të adresuar nevojat e brendshme të vendit. Ndryshimet e shpeshta të legjislacionit sjellin vështirësi të përshtatjes së shpejtë të gjyqtarëve me këto zhvillime. Procedura e verifikimit paraprak të ankimeve në Gjykatën e Lartë shpesh nuk është efektive dhe sjell pasoja të drejtpërdrejta në rritjen e volumit dhe zvarritjen e gjykimit. Volumi i lartë dhe zvarritja e gjykimeve në Gjykatën e Lartë i atribuohet edhe faktorëve të tjerë, si mungesa e reflektimit të ndryshimeve

⁴ Në vitin 2008, për V. B. - gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; në vitin 2009, Q. H. - gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dhe në vitin 2009 M. B. - gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

ligjore dhe institucionale në përbërjen e kolegjeve të kësaj gjykate; procedurat jo transparente të emërimit të gjyqtarëve të lartë; numri i ulët i rekrutimit në këtë Gjykatë nga radhët e gjyqësorit dhe roli i dobët i saj si gjykatë karriere; si dhe mungesa e mekanizmit të vazhdimit të detyrës së gjyqtarëve të lartë deri në zëvendësimin e tyre. Lidhur me efikasitetin e Gjykatës së Lartë, ka nevojë për përmirësimin e studimeve dhe të botimeve institucionale të saj. Megjithëse sistemi CCMIS/ICMIS funksionon plotësisht në sistemin gjyqësor, ai nuk ka dhënë ende efektet e pritshme në drejtim të uljes së ngarkesës dhe përsheptimit të procedurave. Shqetësimi i përbashkët për të gjithë gjyqësorin, për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave gjyqësore, duke i orientuar ato drejt standardeve të procesit të rregullt gjyqësor dhe për të evituar zvarritjet në gjykime, përfshin edhe rastet e zbatimit të ndryshëm të ligjit në çështje të ngjashme, si dhe ekzekutimin e vonuar apo joefektiv të vendimeve gjyqësore. Një prej shkaqeve të dëmtimit të efikasitetit dhe vonësive në gjykim, është identifikuar sjellja dhe mungesa e avokatëve në proceset gjyqësore, e paraqitur prej tyre si taktikë mbrojtjeje, ndërsa në raste të tjera ka pretendime se gjykata dhe administrata gjyqësore nuk respekton si duhet rregullat për njoftimin e palëve. Zvarritja e procedurave gjyqësore bëhet shqetësuese sidomos në rastet kur të miturit janë palë në proces, veçanërisht në procedimet penale, ku ata janë nën masën e sigurisë “arrest në burg”. Vonësia në hetimin paraprak dhe në gjykim shkakton që të miturit të kalojnë dënimin e tyre në paraburgim dhe rrjedhimisht në shkelje të parimit që paraburgimi i të miturve në pritje të gjykimit është një mjet i fundit. Gjithashtu, mbetet për t’u rregulluar infrastruktura ligjore për administrimin e drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët nuk e kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale. Nevojitet përmirësimi i cilësisë dhe i shpejtësisë së procedurave të bashkëpunimit gjyqësor në kuadër të zbatimit të konventave civile dhe penale, në të cilat Shqipëria ka aderuar. Format alternative të zgjidhjeve gjyqësore, si një mjet për të ulur ngarkesën në gjykatë dhe për të siguruar te palët zgjidhjen miqësore nuk perceptohen si shumë të besueshme nga publiku dhe paralelisht me të, infrastruktura ligjore nuk është ende e përshtatshme. Ka një ligj të ri për ndërmjetësimin, i cili nuk është bërë ende efektiv sepse nuk kanë dalë aktet nënligjore në zbatim të tij, ndërsa për arbitrazhin është hartuar projektpolitika dhe po punohet për hartimin e ligjit të veçantë.

- Aksesi në drejtësi

Ka nevojë për të përmirësuar mundësinë për t’iu drejtuar drejtësisë (aksesin në drejtësi) kryesisht në zonat e largëta dhe brenda pakicave etnike. Ndonëse ka një skemë të mirë tashmë për akordimin e ndihmës juridike shtetërore për kategoritë vulnerabël, ka nevojë për implementimin e suksesshëm të saj. Vihet re mungesa e mekanizmave të mjaftueshëm për të siguruar aksesin e publikut në gjykatë. Infrastruktura gjyqësore, ndonëse drejt përmirësimit, vazhdon të jetë e dobët, veçanërisht në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, të cilat janë edhe më të mëdhatë në vend. Arkivat gjyqësore nuk janë të organizuara dhe të ruajtura plotësisht në përputhje me kërkesat e teknologjisë së ruajtjes së dokumenteve arkivore dhe ambientet e arkivave. Pjesa më e madhe e gjykatave nuk kanë hapësirën e nevojshme për ruajtjen e dosjeve gjyqësore. Po kështu, mungon standardizimi i dokumentacionit administrativ nëpër gjykata. Në shtator 2010 janë miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë rregulla formale për marrëdhënien e gjykatave me publikun⁵, megjithatë stafi administrativ është ende i patrajtuar dhe struktura administrative e gjykatave është e papërshtatur me këto rregulla. Sistemi i menaxhimit të çështjeve civile dhe sistemi i menaxhimit të çështjeve penale (CCMIS dhe ICMIS), si në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ka nevojë të konsolidohet dhe të mirëmbahet për të rritur mundësinë e aksesit online në kohë reale në këtë bazë të dhënash kombëtare, si një e vetme, të të gjitha strukturave të drejtësisë në shërbim të funksioneve inspektuese, monitoruese, të organizimit dhe trajnimit të gjyqësorit, përpunuese të të dhënave që vijnë nga sistemi gjyqësor në vend. Gjithashtu, duhen përmirësuar modulet për të krijuar brenda sistemit mbajtje, shkëmbim dhe ndjekje reale të të dhënave, në funksion të krijimit të regjistrit të të dhënave solide (Solid Track Record). Publikimi i vendimeve gjyqësore *online* nëpërmjet ICMIS, ndonëse lehtëson dialogun mes gjykatave dhe profesionistëve të së drejtës, krijon problemin e ekspozimit të të dhënave personale dhe në disa raste të të dhënave sensitive.

⁵ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 6777/5 datë 30.9.2010

1.2 Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)

Veprimtaria e KLD-së është e lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve dhe për rrjedhojë, problemet me të cilat përballen ato i kanë të përbashkëta. Problematikat me të cilat ndeshet sot Këshilli i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të kompetencave tij mund të përmbliken si më poshtë:

- Efiçenca

Në lidhje me organizimin më eficient të punës së Këshillit vërehen këto probleme:

a) Mungesa e një riorganizimi të anëtarëve të Këshillit, për një ndarje më të qartë të detyrave midis trupës së tij, inspektoratit dhe administratës së tij, si dhe për një organizim më efikas të mbledhjeve plenare të tij;

b) Vlerësimi i gjyqtarëve nuk është proces i konsoliduar dhe transparent;

c) Mungesa e harmonizimit të rregullave lidhur me kriteret dhe procedurën e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për shkak të diferencës në kohë të miratimit të ligjit organik të KLD-së dhe ligjit organik të gjykatave;

d) Mungesa e kriterëve në ligj për transferimin e gjyqtarëve të të njëjtit nivel;

e) Roli i dobët i KLD-së në hartimin dhe zbatimin e buxhetit financiar të pushtetit gjyqësor;

f) Staf i administrativ në KLD nuk ka performancën e dëshiruar cilësore dhe procedurat e rekrutimit jo gjithmonë bazohen për thithjen e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë.

- Korrupsioni

Në lidhje me luftën kundër korrupsionit, vërehen këto probleme:

a) Imuniteti i gjyqtarëve, i cili shpesh bëhet pengesë për hetim të shpejtë dhe më eficient të veprimeve korruptive nga ana e gjyqtarëve;

b) Mungesa e rregullave për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve nga Këshilli.

- Procedimi disiplinor i gjyqtarëve

Në lidhje me inspektimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve, vërehen këto probleme:

a) Ndarja e qartë e kompetencave mes inspektoratit të KLD-së dhe atij të Ministrisë së Drejtësisë për inspektimin e gjyqtarëve, të cilat mbivendosen, meqë kompetencat respektive rregullohen nga ligje të veçanta. Në këtë aspekt është e rëndësishme që të evidentohet në aktet ligjore përkatëse kompetencat përkatëse për procedimin disiplinor dhe vlerësimin profesional;

b) Mungesa e rregullave të qarta konform standardeve europiane për veprimtarinë e inspektoratit të Këshillit në raport me inspektimin e gjyqtarëve.

- Veprimtaria e gjykatave

Në lidhje me veprimtarinë e gjykatave, vërehen këto probleme:

a) Mungesa e rregullave të qarta që të lejojnë Këshillin të marrë masa konkrete për adresimin e problemeve që dalin nga inspektimet e gjykatave (probleme lidhur me transparencën e dhënies së drejtësisë, apo infrastrukturën e nevojshme në funksion të respektimit të solemnitetit nga gjyqtarët).

1.3 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ)

Aktualisht ka një nevojë për rritjen e kapaciteteve menaxhuese të ZABGJ-së për të mundësuar identifikimin më të saktë të nevojave financiare të pushtetit gjyqësor, si dhe planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e tij. Qasja e standardeve operuese për sigurimin e kushteve cilësore të punës, gjykimin dhe shërbimit, si nga këndvështrimi i gjyqtarëve, ashtu edhe nga këndvështrimi i qytetarëve është ende e dobët. Prosesi i hartimit të buxhetit dhe i monitorimit të zbatimit të tij nga gjykata duhet të përmirësohet, përmes rritjes së konsultimit me organet e tjera të lidhura me sistemin e drejtësisë dhe rritjes së transparencës. Ky proces jep impakt në administrimin e fondeve buxhetore dhe të objektivave që duhen përmbushur. Veprimtaria e ZABGJ-së perceptohet si jo transparente dhe auditimi i veprimtarisë së ZABGJ-së duket se nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi për auditimin e fondeve në sektorin publik.

1.4 Konferenca Gjyqësore Kombëtare (KGJK)

Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të KGJK-së në drejtim të shprehjes së vullnetit të gjithë gjyqtarëve që përfaqëson për ushtrimin e kompetencave të sakta dhe konform ligjeve nuk janë formalizuar ende në një ligj të veçantë. Edhe pse rregullat ligjore nuk janë miratuar ende në Parlament, nuk ka penguar komunitetin e gjyqtarëve të vetëorganizojë dhe të ushtronte funksionet

kushtetuese drejtpërdrejt. Në KLD ka 7 anëtarë të zgjedhur nga KGJK-ja, 5 anëtarë të zgjedhur në mbledhjen e datës 15 nëntor 2010 dhe 2 anëtarë të zgjedhur në mbledhjen e fundit të datës 8 prill 2011.

Aktualisht, ky organizëm nuk është ende një forum i cili përmbush tërësisht misionin e tij për të kontribuar në rritjen e pavarësisë dhe përballjen me sfidat e tjera të pushtetit gjyqësor. Diskutimet brenda këtij forumi pothuajse mungojnë.

1.5 Shkolla e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës ka ende infrastrukturë dhe ambiente të pamjaftueshme për të siguruar realizimin e të gjithë veprimtarisë trajnuese, akademike dhe administrative të saj. Përmirësimi i infrastrukturës pa dyshim do të ndikojë edhe në cilësinë e mësimdhënies.

Shkolla ka ende mjete të pamjaftueshme financiare, ndonëse mbështetet kryesisht nga Buxheti i Shtetit dhe në plotësim edhe nga partnerë ndërkombëtarë të ndryshëm të interesuar në realizimin e veprimtarisë së saj, sipas ligjit në fuqi, në fushën e trajnimeve dhe botimeve. Për këtë shkak nuk shfrytëzohet sa duhet mundësia ligjore për zhvillimin e trajnimeve të operatorëve të tjerë të drejtësisë. Nga ana tjetër ekziston rreziku i mbivendosjes së projekteve të ndryshme.

Hapja e vendeve vakante për trajnimin fillestar dhe emërimi i magjistratëve të rinj në stazhin profesional janë të brishta dhe mund të shkaktojnë probleme në qëndrueshmërinë institucionale dhe financiare të Shkollës së Magjistraturës për trajnimin fillestar.

Kurrikulat, megjithëse në përmirësim, kanë nevojë të zhvillohen më tej në drejtim të reflektimit të standardeve ndërkombëtare të diktuar nga proceset integruese që po kalon vendi. Me anëtarësimin në Këshillin e Europës, jurisprudenca e GJEDNJ-së përbën një prej burimeve të së drejtës në Shqipëri. Megjithatë, gjyqtarët dhe prokurorët nuk e njohin në mënyrë të mjaftueshme praktikën e kësaj gjykate. Gjithashtu, ata kanë mungesë njohurish mbi veprimtarinë dhe praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë megjithëse Shqipëria është në rrugën e aderimit në Bashkimin Europian. Mbetet i pamjaftueshëm trajnimi i ofruar mbi zhvillimet e reja të legjislacionit, standardet ndërkombëtare, standardet e procesit të rregullt gjyqësor, çështjet e etikës, të logjikës dhe të psikologjisë gjyqësore.

Megjithëse Shkolla ka botuar tekste të literaturës profesionale, ky funksion nuk është i konsoliduar dhe i shtrirë për të gjitha çështjet doktrinare të pushtetit gjyqësor, me fokus në zhvillimet bashkëkohore të doktrinës.

2. Organet e ndjekjes penale

2.1 Prokuroria

Problematika e hasur në organin e prokurorisë është e ngjashme me atë të pushtetit gjyqësor, për shkak të ndërlikohjes së veprimtarisë së këtyre operatorëve. Edhe organi i prokurorisë perceptohet të vuajë nga korrupsioni; nga ndikimet/influencat e të tretëve në veprimtarinë e tij; nga niveli jo i kënaqshëm i procedurave dhe i efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale; dhe nga transparenca e ulët dhe mungesa e besimit të publikut te ky organ.

Lidhur me forcimin e pavarësisë së prokurorëve në procesin e hetimit, ligji për policinë gjyqësore, i cili tashmë ka hyrë në fuqi, ka plotësuar kuadrin ligjor mbi forcimin e kapaciteteve investiguese në polici dhe prokurori. Megjithatë, nevojiten të merren hapa të tjerë, kryesisht, lidhur me plotësimin e kuadrit ligjor në zbatim të risive ligjore të sjella në forcimin e autonomisë së prokurorisë në hetimin paraprak dhe mundësinë për hetime proaktive (7 akte nënligjore).

3. Pushteti ekzekutiv

3.1 Ministria e Drejtësisë

Shtimi i funksioneve dhe agjencive të reja në varësi të Ministrisë së Drejtësisë nxit nevojën për efektivitet dhe bashkërendim me qëllim evitimin e mbivendosjes së kompetencave apo procedurave paralele. Gjithashtu, duhet përmirësuar edhe bashkëpunimi/bashkërendimi me institucionet e pushteteve të tjera, me profesionet e lira, si dhe me aktorët e tjerë dhe grupet e interesit të sistemit të drejtësisë.

Veprimtaria e Ministrisë së Drejtësisë përgjatë procesit legjislativ në kuadër të reformës në drejtësi, kërkon mbështetjen institucionale të profesionistëve, akademikëve, juristëve, praktikienëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të shquar në sistemin e drejtësisë për të dhënë kontributin konkret, për debatimin dhe hartimin e programeve dhe strategjive afatmesme dhe afatgjata të reformës së

drejtësisë dhe të legjislacionit, si dhe për vlerësimin e projektakteve të rëndësishme normative.

Nga ana tjetër nevojitet të përmirësohet më tej raporti i Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e sistemit të drejtësisë në zbatim të parimeve kushtetuese për ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Zgjidhja e këtyre problematikave mbetet e lidhur veçanërisht me nevojën për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Ministrisë së Drejtësisë, të administratës gjyqësore, operatorëve të sistemit të drejtësisë (përmbaruesve gjyqësorë, avokat, noter, ndërmjetës, arbitër, dhe të tjerë profesionistë të fushës), si dhe krijimin e traditës profesionale.

Inspektimet në gjyqësor dhe në prokurori nuk duket të jenë plotësisht funksionale. Ka vërejtje për mbivendosje dhe mungesë bashkërendimi të inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë me atë të KLD-së për shkak të procedurave ligjore jo në përputhje me standardet europiane. Roli për mbikëqyrjen e administratës gjyqësore në funksion të rritjes së performancës dhe transparencës në pushtetin gjyqësor duhet konsoliduar. Gjithashtu, ka nevojë për të përmirësuar procedurat e bashkërendimit mes inspektorateve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si një bazë e shëndetshme për reflektimin e rekomandimeve qeveritare që i adresohen çdo vit prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit.

Hartimi i legjislacionit, përafrimi me *acquis communautaire* dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit të brendshëm mbetet sfidë për Ministrinë e Drejtësisë. Aktualisht, Shqipëria merr pjesë në disa organizma ndërkombëtarë dhe synon aderimin në BE. Për këtë shkak, Shqipëria i nënshtrohet disa proceseve vlerësuese të legjislacionit dhe strukturave zbatuese, duke marrë rekomandime për të ardhmen. Ndonëse ka përpjekje për analizën, planifikimin e masave dhe përbushjen e tyre, vihet re fragmentarizim procesi që shkakton marrje masash jo dhe aq të konsoliduara, koherente dhe rezistente në kohë. Përgjatë procesit legjislativ në kuadër të reformës në drejtësi, duhet forcuar dialogu institucional me profesionistët, akademikët, praktikienët, gjyqtarët dhe prokurorët e shquar në sistemin e drejtësisë për të dhënë kontributin konkret, për hartimin dhe konsultimin e politikave dhe nismave ligjore të reformës së drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror vendas për ofrimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar. Me gjithë zhvillimet ligjore, duhet përmirësuar ende cilësia dhe shpejtësia e veprimeve në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, si në fushën civile, ashtu edhe në fushën penale. Numri i akteve ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria merr pjesë është në rritje dhe krijon vështirësinë e njohurive profesionale të stafit administrativ të Ministrisë. Ndonëse Shqipëria aspiron për të ardhmen europiane, ende nuk është finalizuar lidhja e një marrëveshjeje të bashkëpunimit në fushën e drejtësisë me strukturën e EUROJUST-it. Aktualisht pritet përcjellja e komenteve mbi draftmarrëveshjen.

Lidhur me nivelin e kapaciteteve administrative të Ministrisë së Drejtësisë dhe orientimin e tyre drejt përvojave më të mira mbetet domosdoshmëri trajnimi i vazhdueshëm dhe i profilizuar sipas vendeve të punës.

Aktualisht nuk ka një sistem të integruar kompjuterik të të dhënave të të gjitha agjencive ligjzbatuese në sistemin e drejtësisë për një qeverisje elektronike.

Në tabelën e mëposhtme përshkruhen investimet e kryera të financuara nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me donatorë të huaj për përmirësimin e infrastrukturës së operatorëve të sistemit të drejtësisë.

NR.	PROGRAMI	PROJEKTI	FINANCIMI	STATUSI
1.	CARDS2003 CARDS 2004	Ndërtimi i Gjykatës së Krimeve të rënda Kontrata 2006 /123-948 Blerje e pajisjeve Kontrata 2007/143-407 Lot 1 2007/143-406 Lot 2 2007/143-429 Lot 3	Ndërtimi 4.470.000 euro Financues: BE TVSH 894.000 euro Financues: Shteti Shqiptar Blerje 616.400 euro Financues: BE TVSH 122.480 euro Financues: Shteti Shqiptar	Ka përfunduar garancia e punimeve dhe është firmosur certifikata e finale e pranimit të punimeve. Ka përfunduar garancia e punimeve dhe pritet të firmoset certifikata finale e pranimit të tyre.
2.	CARDS 2004	Rinovim “Qendra e Publikimeve Zyrtare” Kontrata 2007/143-563	393.300 euro	Përfunduar
3.	CARDS 2004	Ndërtim Qendra për Riintegrimin e të Miturve, Kavajë Kontrata 2007/ 143-631	1.737.567 euro	Përfunduar
4.	CARDS 2004	Orendi dhe pajisje për administratën gjyqësore ICMIS	250.000 euro	Përfunduar
5.	CARDS 2004	KLD Projekti i binjakëzimit Kontrata 2006/ 128 - 829	700.000 euro	Finalizuar në 2008
6.	CARDS 2004	Trajnimi i administratorëve të gjykatave Kontrata 2005/ 10 – 976	400.000 euro	Finalizuar në 2008
7.	CARDS 2005	Binjakëzim “Mbështetje për Prokurorinë e Përgjithshme për realizimin e inspektimeve dhe vlerësimet e prokurorëve” Kontrata	800.000 euro	Afati kohor: tetor 2008 - mars 2010

		CRIS 164 - 344		
8.	CARDS 2005	Rinovim “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër” Kontrata 2007/ 141- 575	320.809 euro	Përfunduar
9.	CARDS 2005	Rinovim “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë” Kontrata 2007/141-576	409.064 euro	Përfunduar

3.2 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Zbatimi i të drejtave të njeriut, sidomos i atyre të të burgosurve, janë në fokus të vazhdueshëm të reformave të ndërmarra, përmes parimeve të ligjshmërisë, humanizmit dhe sigurisë juridike. Sistemi penitenciar ka pasur investime të vazhdueshme për përmirësimin e legjislacionit, infrastrukturës dhe zbatimin efektiv të ndryshimeve strukturore përmes orientimit të politikave që kufizojnë dhe ulin numrin e personave që dënohen me burgim dhe për mbajtjen e popullsisë në burgje në nivel të menaxhueshëm. Trajtimi i personave të paraburgosur apo të dënuar dhe shndërrimi i dënimit penal në një mundësi të rehabilitimit social është në vëmendje të posaçme.

Kërkohen përpjekje të mëtejshme për arritjen e standardeve ndërkombëtare, sidomos atyre europiane dhe me fokus të veçantë të të miturit. Gjithashtu, kërkohen masa efektive për minimizimin dhe evitimin e rasteve të keqtrajtimeve fizike dhe psikologjike, sidomos të atyre në mbikëqyrje të policisë dhe me fokus të veçantë të të miturit.

Ka ende qendra të ekzekutimit të dënimeve penale që funksionojnë mbi kapacitetet dhe mbeten për t’u përmirësuar kushtet e përgjithshme të tyre, duke përfshirë edhe ndonjë qendër paraburgimi apo rajon policie. Duhet rritur aksesin në shërbimet mjekësore të përshtatshme, sidomos ato që lidhen me kujdesin psikologjik dhe psikiatrik. Ndonëse vazhdimisht zhvillohen trajnime të stafit policor dhe civil të sistemit penitenciar, ka nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Duhet nxitur dialogu dhe bashkëpunimi institucional me Avokatin e Popullit (që ka edhe mekanizmin kundër torturës) me qëllim analizën dhe planifikimin e saktë të rekomandimeve të dhëna prej tij. Duhet forcuar sistemi i inspektiveve dhe i finalizimit të procedurave të përgjegjësive administrative dhe penale të rasteve të shkeljes së ligjit nga stafi policor dhe civil. Gjithashtu, duhet nxitur bashkëpunimi institucional mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës, si dy mekanizma në funksion të të njëjtit qëllim “edukimin dhe riintegrimin social të të dënuarve”.

Shpenzimet publike dhe financimet ndërkombëtare në sistemin penitenciar gjatë tre viteve të fundit janë përmirësuar ndjeshëm. Në kuadër të projektit IPA 2007, financiar nga BE, kanë filluar punimet e Qendrës së Paraburgimit të ri të Elbasanit me një kapacitet prej 120 personash. Ky investim parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2011. Njëpërmjet të njëjtit financim IPA 2007, është financiar gjithashtu edhe qendra e paraburgimit të Fierit me kapacitet 120 persona. Duke synuar objektivin e lartpërmendur sistemi i drejtësisë investon nëpërmjet financimit të IPA 2008, ndërtimin e qendrës së paraburgimit të Beratit për të cilin kanë filluar punimet në nëntor 2010 dhe planifikohet të përfundojë në fund të vitit 2011. Gjithashtu, nëpërmjet IPA 2010, sistemi i drejtësisë investon për ndërtimin e burgut të Fierit me një kapacitet prej 600 personash, për të cilin priten të fillojnë punimet në ditët në vijim. Gjithashtu, nëpërmjet IPA 2011, Ministria e Drejtësisë së bashku me Delegacionin e Komisionit European në Tiranë kanë vënë në prioritet ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit dhe burgut të Shkodrës në një investim me vlerë 18 milionë euro.

Konkretisht shpenzimet publike pasqyrohen në tabelën e mëposhtme për periudhën 2009-2013:

Vitet	2009	2010	2011	2012	2013
Vlera në mijë lekë	205.058	239.870	441.000	573.000	1.340.000

3.3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

Institucioni i Shërbimit të Provës ka filluar të funksionojë në muajin qershor 2009 dhe aktualisht, ushtrojnë funksionin 8 zyra vendore, veprimtaria e të cilave mbulon të gjithë territorin. Megjithatë, ende nuk ka traditë të konsoliduar që garanton profesionalizimin dhe efektivitetin e procesit të mbikëqyrjes dhe rehabilitimit të të dënuarve. Si një shërbim i ngritur së fundmi, ky institucion nuk ka konsoliduar marrëdhëniet me publikun, gjykatat, prokurorinë, policinë, sistemin penitenciar, autoritetet lokale dhe OJQ-të. Aktualisht ai po asistohet nga Projekti i Binjakëzimit me Shërbimin e Provës Britanik, (*Albanian Twinning Project – Probation Service, AL 09 IB JH 01 “Support to the Establishment of the Probation Service and Alternative Measures to Detention”*), financiar në kuadër të Programit IPA 2009 në vlerën prej 1 milion euro për periudhën 2-vjeshore (janar 2011 – janar 2013). Ndërkohë që nga buxheti i shtetit, për vitin 2011 është planifikuar shuma prej 15.150.000 lekësh për mbulimin e shpenzimeve strukturë shtesë për 4 zyrat e saj vendore që priten të hapen së shpejti.

3.4 Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror shfaq probleme në cilësi dhe efikasitet të shkaktuara si nga mungesa e mjeteve logjistike e financiare, ashtu edhe nga kapacitetet administrative. Cilësia dhe efektiviteti jo në nivelin e duhur kanë ulur numrin e ekzekutimeve të suksesshme.

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Privat, duke qenë një veprimtari e sapokrijuar, kërkon mbështetje logjistike, institucionale dhe profesionale në drejtim të standardizimit të punës së përmbaruesve privatë. Deri më tani janë certifikuar nga Ministri i Drejtësisë, 62 përmbarues gjyqësorë privatë. Gjithashtu, është realizuar projekti (sistemi i ri i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor), me investimet e planifikuara në PBA-në e vitit 2010-2012, me vlerë të kontraktuar 44,539,920 lekë. I gjithë sistemi aktualisht është në proces dinamik të krijimit të të dhënave të integruara automatike të menaxhimit të çështjeve për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe kryerjen e analizave të përshtatshme në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe rakordimit të marrëdhënieve institucionale mes dy shërbimeve.

3.5 Qendra e Publikimeve Zyrtare (QPZ)

QPZ-ja vazhdon të jetë një institucion i cili me anë të botimeve dhe publikimeve kryen njohjen dhe nëpërmjet saj hyrjen në fuqi të akteve ligjore e nënligjore, si dhe të vendimeve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Si e tillë, ajo duhet t'i nënshtrohet përmirësimit të standardit të publikimit dhe shpalljes së akteve ligjore në përputhje dhe me vendet e tjera, si dhe objektivat afatgjata institucionale në kuadër të epokës digjitale.

Në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, me qëllim parapërgatitjen e standardizimit të sistemit të menaxhimit të të dhënave dhe arkivimit të informacionit ligjor, sipas atij europian, është menduar që në të ardhmen sistemi ynë i menaxhimit të të dhënave të përfshihet në sistemin europian të indeksimit të akteve ligjore të quajtura EUROVOC.

3.6 Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB)

Në fushën e birësimeve, implementimi i standardeve dhe procedurave ligjore për birësimet brenda dhe jashtë vendit përbën një nga problemet kryesore të këtij institucioni.

3.7 Avokatura e Shtetit

Tashmë është vlerësuar si sfidë dhe domosdoshmëri e kohës, fuqizimi dhe modernizimi i këtij institucioni, me fokus të veçantë në rritjen e nivelit të ekspertizës që i duhet ofruar strukturave shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre dhe rritjen e cilësisë së mbrojtjes ligjore që i duhet garantuar shtetit. Nëpërmjet organizimit dhe strukturimit të Avokaturës së Shtetit sipas ligjit në fuqi, vazhdimi të reformës, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe përputhjes së tij me standardet europiane, përmirësimit të kushteve të punës, infrastrukturës dhe trajtimit të trupës avokatore, punimit të

vazhdueshëm në drejtim të unifikimit të praktikës ligjore dhe rritjes së nivelit të përfaqësimit dhe profesionalizimit në gjykatat kombëtare, Strasburgut dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, synohet të ndikohet në uljen e korrupsionit në organet e administratës shtetërore dhe organet e drejtësisë. Në këtë kuadër roli i Avokaturës së Shtetit do të ndihmojë edhe më gjerë në objektivat e qeverisë siç është lufta kundër korrupsionit.

3.8 Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)

Lidhur me veprimtarinë e IML-së janë vënë në dukje vështirësitë e mungesës së personelit të kualifikuar të emëruar si ekspertëve të jashtëm në rrethe dhe në disa rrethe të vendit ka lindur nevoja e zëvendësimit të ekspertëve të cilët kanë dalë në pension.

Problem tjetër i hasur gjatë veprimtarisë së këtij institucioni është edhe asgjësimi i provave materiale (bimë dhe lëndë narkotike) mbetje nga analizat toksikologjike, të cilat nuk tërhiqen nga organet e procedimit penal që kanë kërkuar ekspertimin, si dhe ndryshime në tarifatat e ekspertimit që kryhen nga ky institucion. Gjithashtu problematik është mospërdorimi i një përqindjeje të caktuar i të ardhurave dytësore, për nevoja të Institutit si përfitimi në një përqindje të caktuar të ekspertëve të cilët paraqiten në gjykatë.

4. Profesionet e lira

Edhe pse të lira dhe private, në një shtet demokratik, këto profesione vishen me tiparet e një shërbimi publik. Rrjedhimisht disa çështje vendimtare mbi profesionet e lira duhet të përcaktohen në mënyrë të përbashkët ose të jenë subjekt i mekanizmave të kontrollit ligjor, madje në disa raste edhe të kontrollit demokratik, duke krijuar një rrjet intervarësie. Kërkohej koordinim dhe bashkëpunim ndër-institucional, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, ashtu edhe midis vetë strukturave të profesioneve të lira. Fragmentarizimi që përshkon shpesh profesionet e lira bëhen pengesë për reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve dhe investimeve në fuqizimin e profesionalizimit të tyre.

Kërkohej transparencë dhe monitorim periodik i veprimtarisë së tyre. Ndryshimet në kuadrin ligjor janë të nevojshme për reformimin e profesioneve të lira, me qëllim rritjen e performancës së veprimtarisë, si aktorë të rëndësishëm në realizimin e dhënies së drejtësisë, si dhe për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, në këtë drejtim. Publiku nuk është shumë i njohur mbi ekzistencën e disa profesioneve të lira dhe me avantazhet e veprimtarive të tyre, si ndërmjetësit dhe arbitrat. Kuadri ligjor për rregullimin e tyre është ende në proces. Gjithashtu, kërkohej ndërgjegjësim i publikut për skemën e ndihmës juridike falas, si dhe forcimi i bashkëpunimit të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike me profesionet e lira, sidomos me Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

KAPITULLI II VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Vizioni

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ka për mision të mbrojtë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë. Bazuar në arritjet e deritanishme dhe potencialet e rritjes së vendit, si dhe në përputhje me vizionin e përcaktuar në Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI), Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë përcakton vizionin e mëposhtëm për vitet e ardhshme:

“Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike si një shtet i së drejtës, demokratik dhe garant i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo.”

Sfidat

Shqipëria është futur në një fazë të re zhvillimi dhe me perspektiva të qarta integrimi në strukturat euro-atlantike. Shteti shqiptar, duke zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë dhe duke respektuar parimet themelore të një vendi demokratik, do të jetë mbrojtës i të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe interesave të tyre. Garanci për këtë do të jetë qeverisja e mirë, e drejtë dhe e paanshme, e orientuar drejt filozofisë së zbatimit të ligjit për funksionimin e shoqërisë dhe hapjen e rrugës së zhvillimit.

Në periudhën afatmesme që kjo strategji trajton sfidat e paraqitura, ndër të tjera, mbulojnë hartimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi me objektiv vlerësimin profesional dhe objektiv të gjyqtarëve e prokurorëve, forcimin e statusit të tyre, zbatimin dhe përmirësimin e sistemit të teknologjisë së informacionit në gjyqësor, si dhe harmonizimin e ligjeve organike të sistemit të drejtësisë, zbatimin e *acquis communautaire* dhe të standardeve të Bashkimit Europian, si dhe konsolidimin e mekanizmave ndërinstitucionalë të bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme të gjyqësorit; rritjen e kapaciteteve brenda administratës së gjyqësorit dhe prokurorëve, krijimin e gjykatave të specializuara administrative. Në vijim, përmirësimi i nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë, konsolidimi i performancës së shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror dhe privat, si dhe përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të individit, krijimi i kushteve të duhura për zbatimin me rreptësi të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, janë aspekte të tjera shumë të rëndësishme të cilat mbulohen në këtë strategji dhe që parashikohet të plotësohen në një periudhë afatmesme.

Janë pikërisht institucionet e drejtësisë përgjegjëse për përmbushjen e qëllimeve strategjike dhe të harmonizimit midis misionit dhe vizionit të sistemit të drejtësisë, sidomos: Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, si dhe operatorët dhe aktorët e tjerë të interesuar.

Prioritetet dhe qëllimet strategjike

Në terma konkretë, prioritetet dhe qëllimet strategjike për sistemin e drejtësisë në përgjithësi për t'u realizuar deri në vitin 2013 konsistojnë në mënyrë të përmbledhur në zbatimin e objektivave strategjike të listuara si më poshtë, sipas rëndësisë së tyre, duke i klasifikuar në objektiva shumë të rëndësishëm, të rëndësishëm dhe normalë.

1. Konsolidimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të organeve të sistemit të drejtësisë në drejtimin strukturor, funksional dhe financiar (shumë i rëndësishëm);

2. Konsolidimi i dialogut ndërinstitucional dhe bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe të gjithë aktorëve të tjerë me kontribut në fushën e drejtësisë, me qëllim ndërtimin dhe konsolidimin e besimit dhe konsensusit të nevojshëm mes forcave politike parlamentare për reformën në drejtësi dhe përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor (i rëndësishëm);

3. Konsolidimi i përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë për të qenë i pandikuar, i paanshëm dhe konsistent në sigurimin e mbrojtjes ligjore të barabartë për të gjitha palët, si dhe për të qenë i gatshëm për të reaguar ndaj nevojave në ndryshim të komunitetit në kohë dhe në cilësi (shumë i rëndësishëm);

4. Konsolidimi i pushtetit gjyqësor për të qenë efektiv, eficient dhe i hapur, si dhe i gatshëm për të vepruar në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm duke u udhëhequr nga parimi i shtetit të së drejtës (shumë i rëndësishëm);

5. Fuqizimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (shumë i rëndësishëm);

6. Konsolidimi i aksesit në organet e drejtësisë për të qenë i hapur për çdo person dhe për të qenë aktivisht i angazhuar në inkurajimin e formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (i rëndësishëm);

7. Konsolidimi i besimit të publikut në pushtetin gjyqësor për të qenë i drejtë dhe i respektueshëm ndaj të gjithëve (shumë i rëndësishëm);

8. Konsolidimi i qeverisjes së mirë, përmes luftës ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integritimit e vendit dhe garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës (shumë i rëndësishëm);

9. Konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve, duke realizuar integritimin e vendit në BE nëpërmjet përmbushjes së plotë të standardeve europiane (i rëndësishëm);

10. Përmirësimi i nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë në

nivele të ngjashme me ato të vendeve të Bashkimit Europian dhe përmirësimi i performancës së Shërbimit Përmbartimor Shtetëror dhe Privat (i rëndësishëm);

11. Përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të individit, krijimi i kushteve të duhura për zbatimin me rreptësi të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke garantuar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi (i rëndësishëm);

12. Mirëfunksionimi i sistemit përmes investimeve në infrastrukturën e gjykatave dhe kushtet e punës (normal);

13. Përmirësimi i procesit të hartimit të legjislacionit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin profesional të tyre, rritjen e vëmendjes ndaj *acquis communautaire* me qëllim përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit (normal).

Prioritetet dhe qëllimet strategjike janë identifikuar si të ndërlidhura me njëra-tjetrën, të cilat të gjitha së bashku përmbushin vizionin qeveritar. Megjithatë, midis tyre, prioritetet dhe qëllimet strategjike të numërtuara 1, 3, 4, 5, 7, 8 paraqiten si shumë të rëndësishme. Ato të numërtuara 2, 6, 9, 10 dhe 11 paraqiten si të rëndësishme, ndërsa 12 dhe 13 me rëndësi normale. Klasifikimi i tyre sipas rëndësisë paraqet radhën e prioriteteve, jo sipas kohës së përmbushjes së tyre, por duke reflektuar mbi të gjitha, angazhimin politik për përmbushjen e tyre në raport të drejtë me nevojat më emergjente dhe shkallën e problematikës së sektorit të drejtësisë.

KAPITULLI III POLITIKAT

Në përputhje me vizionin dhe prioritetet dhe qëllimet strategjike, kapitulli trajton politikat. Duke konsideruar se prioritetet dhe qëllimet strategjike ndërthuren me njëra-tjetrën kjo gjithashtu, ndikon në politikat për zbatimin e tyre. Për këtë arsye prioriteti dhe qëllimi strategjik nr.2 është i plotë dhe i zbatueshëm nga politikat e çdo prioriteti dhe qëllimi strategjik, por mbi të gjitha nga politikat e prioritetit dhe qëllimit strategjik nr.1. Ndërsa prioritetet dhe qëllimet strategjike nr.4 dhe 5 parashikohen të zbatohen sipas politikave të njëjta. Prioritetet dhe qëllimet strategjike nr.7 dhe 8 parashikohen të zbatohen sipas politikave të njëjta dhe prioritetet dhe qëllimet strategjike nr.9, 10 dhe 11 parashikohen të zbatohen sipas politikave të njëjta.

Politikat kryesore që do të ndërmerren janë:

1. Konsolidimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe i organeve të sistemit të drejtësisë në drejtimin strukturor, funksional dhe financiar (shumë i rëndësishëm):

1.1 Lehtësimi i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor dhe rritja e aftësisë së tij për të ndikuar te dy pushtetet e tjera (shumë i rëndësishëm).

1.2 Forcimi i kontributit të KLD-së në funksionimin e pushtetit gjyqësor, për një drejtësi të pavarur, transparente, efikase e me besim te publiku, si dhe për të garantuar ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të tij (shumë i rëndësishëm).

1.3 Përmirësimi strukturor i Gjykatës së Lartë për rritjen e ndikimit, autoritetit dhe integritetit të saj (shumë i rëndësishëm).

1.4 Profilizimi i mëtejshëm i gjykatave në dhënien e drejtësisë (i rëndësishëm).

1.5 Rritja e kapaciteteve menaxhuese të sistemit të drejtësisë (i rëndësishëm).

1.6 Administrimi i pavarur i buxhetit gjyqësor duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstucional dhe siguruar skemë funksionale (shumë i rëndësishëm).

1.7 Garantimi i standardeve kushtetuese përmes rritjes së efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese (shumë i rëndësishëm).

2. Konsolidimi i përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë për të qenë i pandikuar, i paanshëm dhe konsistent në sigurimin e mbrojtjes ligjore të barabartë për të gjitha palët, si dhe për të qenë i gatshëm për të reaguar ndaj nevojave në ndryshim të komunitetit në kohë dhe në cilësi (shumë i rëndësishëm):

2.1 Përmirësimi i statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe zbatimi efikas i legjislacionit lidhur me (shumë i rëndësishëm):

- a) pagën;
- b) imunitetin;
- c) emërimin;
- d) promovimin;
- e) procedimin disiplinor;
- f) vlerësimin profesional;
- g) barazinë gjinore.

2.2 Qartësimin e kompetencave të inspektorateve të Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së (shumë i rëndësishëm).

2.3 Forcimi i rolit dhe pavarësisë së prokurorit në procesin e hetimit (i rëndësishëm).

3. Konsolidimi i efektivitetit të pushtetit gjyqësor për të qenë efektiv, eficient dhe i hapur, si dhe i gatshëm për të vepruar në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, duke u udhëhequr nga parimi i shtetit të së drejtës, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar (shumë i rëndësishëm):

3.1 Reduktimi i mbingarkesës së gjykatave dhe zvarritjeve të çështjeve gjyqësore (shumë i rëndësishëm).

3.2 Rritja e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe orientimi i sistemit gjyqësor drejt praktikave më të mira europiane për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët (shumë i rëndësishëm).

3.3 Përmirësimi i procesit të seleksionimit të kandidatëve për magistratë, formimit dhe vlerësimit të tyre (i rëndësishëm).

3.4 Përfshirja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e publikimeve dhe forcimi i punës kërkimore shkencore (i rëndësishëm).

3.5 Përmirësimi i ekspertizës së specializuar në proceset gjyqësore (i rëndësishëm).

3.6 Rritja e shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar (shumë i rëndësishëm).

3.7 Implementimi në kuadrin ligjor të sistemi ICMIS (shumë i rëndësishëm).

3.8 Përmirësimi i infrastrukturës elektronike të gjykatave dhe prokurorive (shumë i rëndësishëm).

4. Konsolidimi i aksesit në organet e drejtësisë për të qenë i hapur për çdo person dhe për të qenë aktivisht i angazhuar në inkurajimin e formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (i rëndësishëm):

4.1 Rritja e aksesit të publikut dhe profesionistëve për njohjen e legjislacionit (i rëndësishëm).

4.2 Efektiviteti i ndihmës juridike (shumë i rëndësishëm).

4.3 Përmirësimi i marrëdhënies me publikun (shumë i rëndësishëm).

4.4 Efektiviteti i formave alternative (i rëndësishëm).

4.5 Përmirësimi dhe forcimi i rolit të aktorëve ndihmës të sistemit të drejtësisë, profesionet e lira (i rëndësishëm).

5. Konsolidimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë paralelisht me konsolidimin e qeverisjes së mirë, përmes luftës ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integritimit të vendit, si dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës (shumë i rëndësishëm):

5.1 Rritja e efektivitetit dhe bashkërendimit me organet e pushteteve të tjera dhe agjencitë e pushtetit ekzekutiv, si dhe me profesionet e lira dhe grupet e interesit (shumë i rëndësishëm).

5.2 Përmirësimi i procesit legjislativ dhe përsheptimi i procesit të përafrimit me fokus edhe rregullat antikorrupsion (i rëndësishëm).

5.3 Krijimi i sistemeve regjistruese solide për krimin e organizuar dhe luftën kundër korrupsionit (shumë i rëndësishëm).

5.4 Zbatimi me efektivitet i detyrimeve të Strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e luftës kundër korrupsionit dhe për një qeverisje më transparente, 2008-2013, të miratuar me

vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1561, datë 3.10.2008, dhe të planeve të veprimit të çdo viti, përfshirë edhe planin e veprimit 2011– 013, të miratuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP), në mbledhjen e datës 6.6.2011 (shumë i rëndësishëm).

6. Konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të individëve, duke përmirësuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore; të drejtat e të burgosurve dhe të paraburgosurve, si dhe të drejtat e fëmijëve (i rëndësishëm):

6.1 Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore (i rëndësishëm).

6.2 Përmirësimi i të drejtave të të izoluarve përmes (shumë i rëndësishëm):

a) investimeve;

b) sigurisë së sistemit penitenciar;

c) trajtimi ushqimor dhe medikamentoz;

d) trajnimeve;

e) punësimit;

f) rehabilitimin;

g) forcimit të ndjekjes gjyqësore të ndjekjeve gjyqësore për keqtrajtim;

h) përmirësimin të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

6.3 Rritja e pavarësisë, përgjegjshmërisë transparencës dhe efikasitetit në sistemin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative (i rëndësishëm).

6.4 Rritja e qëndrueshme e nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore konform standardeve europiane, si edhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit përmbartimor (shumë i rëndësishëm).

6.5 Shtrirja e sistemit ALBIS dhe konsolidimi i tij në përmbartimin gjyqësor privat dhe shtetëror (shumë i rëndësishëm).

6.6 Përmirësimi i të drejtave të fëmijëve (i rëndësishëm).

7. Mirëfunksionimi i sistemit përmes investimeve në infrastrukturën e gjykatave dhe të prokurorisë, si dhe kushtet e punës (normal):

7.1 Investimi i mëtejshëm në gjykata dhe prokurori (normal).

7.2 Përmirësimi i kushteve dhe mjediseve të punës në prokurori (normal).

7.3 Ndërtimi i Gjykatës Administrative (normal).

7.4 Përmirësimi i kushteve të punës në gjykata (normal).

8. Përmirësimi i procesit të hartimit të legjislacionit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin profesional të tyre, rritjen e vëmendjes ndaj *acquis communautaire* me qëllim përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit (normal).

8.1. Qëndrueshmëria e stafit të kualifikuar nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimin të kushteve të punës për rritjen e aftësive të tyre (normal).

8.2. Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, duke përfshirë edhe shoqërinë civile (i rëndësishëm).

8.3. Ndjekja e politikave specifike sipas prioriteteve dhe qëllimeve të tjera strategjike që kanë lidhje me procesin legjislativ (normal).

KAPITULLI IV RRJEDHOJAT PËR BURIMET

Në këtë seksion trajtohen në mënyrë të përmbledhur referencat që lidhen me nevojat për përdorimin e burimeve financiare, të nevojshme për zbatimin e strategjisë së reformës në drejtësi. Në këtë kuadër, ashtu siç sugjeron dhe metodologjia për hartimin e strategjive sektoriale/ndërsektoriale, referenca është kryer me planet buxhetore të planifikuara në Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI), si dhe Programin buxhetor afatmesëm (PBA).

Më konkretisht, procesi afatmesëm dhe afatgjatë për planifikimin strategjik, që është SKZHI 2007-2013 i cili përcakton përparësitë dhe synimet strategjike, si dhe PBA që kërkon që çdo ministri të përgatisë një plan trevjeçar brenda një tavani shpenzimesh të përcaktuar. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve korrik dhe tetor.

Gjithashtu, në identifikimin e nevojave për burime financiare, një vend të rëndësishëm do të zënë dhe projektet e huaja në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA), si dhe detyrimet e dala në kuadër të procesit integruar të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Siç dhe është bërë një praktikë e konsoliduar tashmë, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale janë në proces rishikimi të vazhdueshëm, përmes hartimit çdo vit të PBA-së, me një cikël trevjeçar.

Në këtë kontekst, strategjia e reformës në drejtësi dhe plani i saj i veprimit do të jenë subjekt i vazhdueshëm rishikimi dhe do të sigurojnë bazën e informacionit për përcaktimin e taveve buxhetore. Gjithashtu, edhe plani i integruar, i cili rifreskohet çdo vit, do të shërbejë si një bazë e mirë monitorimi dhe ushqyes për nevojat për financime nga buxheti i shtetit apo përmes financimeve të huaja.

Në dhënien e shifrave të mëposhtme, në tabelën nr.1, i jemi referuar informacionit të siguruar për tavanet përgatitore të përgatitura nga Ministria e Financës, në kuadër të fazës së dytë të përgatitjes së PBA-së 2011-2013. Këto të dhëna referojnë tavanet buxhetore të alokuara përgjatë viteve 2011-2013 për institucionet e poshtëpërmendura, si vijon: Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Shkolla e Magjistraturës dhe Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, programet buxhetore afatmesme 2011-2013 të institucioneve të sipërpërmendura përmbajnë informacion mbi objektivat dhe aktivitetet e nevojshme që do të kryhen për realizimin e objektivave madhorë të vendosura nga çdo institucion. Parashikohet që këto dokumente të dorëzuara tashmë pranë Ministrisë së Financave do të jenë subjekt rishikimi të buxhetit. Megjithatë, një pasqyrë përmbledhëse e projekteve të parashikuara për çdo institucion do t'i bashkëngjitet planit të veprimit të kësaj strategjie si pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Tabela nr.1

TAVANET PËRGATITORE TË PBA-SË 2010-2013

Emërtimi	Tavanet (në milionë lekë)				Ndryshimi Vjetor		
	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013
Përmbledhëse sipas strukturës së shpenzimeve							
Totali i sistemit të MD	5,833	6,354	6,727	9,381	8.9%	5.8%	39%
Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1,660	1,711	1,831	1,908	3.1%	7%	4.2%
Prokuroria e Përgjithshme	1,236	1,286	1,373	1,432	4.1%	6.8%	4.2%
Gjykata Kushtetuese	99	101	105	110	2%	3.9%	4.7%
Shkolla e Magjistraturës	52	53	55	58	1.9%	3.7%	5.4%
TOTAL I+II+III+IV+V	8,880	9,505	10,091	12,889			

Gjithashtu, donatorë partnerë të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Drejtësisë, përmes zbatimit të projekteve të IPA-së, LAMP (Land Administration and Management Project) do të vazhdojnë të luajnë një rol kryesor në financimin e projekteve të nisura apo të planifikuara për t'u financuar. Tabela e mëposhtme siguron një informacion të përmbledhur mbi projektet e financuara si dhe ato të pritshme nga donatorë partnerë që operojnë në sistemin e drejtësisë.

INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI PROJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ
PROJEKTET NË ZBATIM NË SISTEMIN E DREJTËSISË

PROJEKTI	STATUS	FINANCIMI
C A R D S		
Projekte të përfunduara		
Orendi dhe pajisje për administratën gjyqësore ICMIS CARDS 2004	Përfunduar	Buxheti 250.000 euro
Ndërtim Qendra për Riintegrimin e të Miturve, Kavajë CARDS 2004 Kontrata 2007/143-631	Objekti i ndërtuar	Ndërtim 1.737.567 euro
Rinovim “Qendra e Publikimeve Zyrtare” CARDS 2004 Kontrata 2007/143-563	Objekti i rinovuar	Rinovimi 393.300 euro
Rinovim “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë CARDS 2005 Kontrata 2007/141-576	Objekti i rinovuar	Rinovimi 409.064 euro
Rinovim “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër” CARDS 2005 Kontrata 2007/141- 575	Objekti i rinovuar	Rinovimi 320.809 euro
Ndërtimi i Gjykatës së Krimeve të rënda Pajisjet	Objekti i ndërtuar	Buxheti për pajisjet 470.000 euro
ALBPOS – CARDS 2005 Kontrata 2008/164-535	Përfunduar	Buxheti 1,161,000 euro
EUROALIUS II- CARDS 2006 Kontrata 2007/146-012	Përfunduar 15 nëntor 2007- 30 qershor 2010	Buxheti 2.5 mln euro
Totali		7.241.740 lekë
Projekte në zbatim		
Ndërtim Qendër Paraburgimi Elbasan IPA 2007 Kontrata 2009/228-751	Punimet kanë filluar në maj 2010 dhe janë parashikuar të përfundojnë në shtator 2011.	Ndërtimi 3.4 milionë euro
Ndërtim Qendër Paraburgimi Berat. IPA 2008 Kontrata 2010/242-656	Pritet fillimi i ndërtimit në muajin dhjetor 2010	Ndërtimi 2.99 milionë euro
Ndërtim Qendër Paraburgimi dhe Burg Fier IPA 2007-2010	Pritet të fillojnë punimet në dhjetor 2010	Ndërtimi 17.3 milionë euro Pajisje/mobilim 1.7 milion euro Faza I IPA 2007 5.3 m euro (tvsh Qeveria SH)

		Faza II IPA 2010 12 m euro (tvsh Qeveria SH) IPA 2010 1.7 m euro (mobilim 100% Qeveria SH)
Projekt binjakëzimi Shërbimi i Provës IPA 2009	Parashikohet të fillojë në muajin janar 2011	Buxheti 1.000.000 euro
Konsolidimi legjislativ dhe institucional i sistemit të drejtësisë (Euroalium III) IPA 2009	Ka filluar në muajin shtator 2010	Buxheti 3.3 milionë euro
LAMP Projekti i administrimit dhe menaxhimit të tokave. Komponenti A Banka Botërore	Ky projekt mbulon më së shumti çështje që lidhen me të drejtat e pronësisë	Buxheti 19.4 milionë USD (IBRD/IDA 16.1 milionë SIDA 3.33 milionë) (15.1 milionë euro)
TOTALI		48.690.000 euro + 19.400.000 USD
IPA Projekte në të ardhmen		
Qendër Burg/Paraburgimi Shkodër IPA 2011	Vitet 2012- 2014	Kontributi i EU 15.3 mln euro Kontributi Shqiptar 2.70 mln euro
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë IPA 2011	Vitet 2012- 2014	Kontributi i EU 4.9 mln euro Kontributi Shqiptar 0.86 mln euro
TOTALI		23.760.000 euro

Në vijim, në përlogaritjen e burimeve financiare të nevojshme për zbatimin e kësaj strategjie, referenca është ndaj buxhetit të shtetit të alokuar në PBA 2011-2013 respektivisht për çdo institucion, si dhe projekteve me financim të huaj që janë në proces zbatimi apo parashikohet të fillojnë zbatimin në periudhën në vijim, të dhëna të parashtruara në tabelën nr.1 dhe nr.2 më lart.

Gjithashtu, siç dhe u përmend më lart, dokumentacioni i PBA-së 2011-2013 ndihmon hartimin e planveprimit që do të shoqërojë dokumentin e strategjisë së reformës në drejtësi, si pjesë përbërëse e tij. Parashikohet që çdo institucion pjesëmarrës në hartimin e kësaj strategjie do të plotësojë informacionin e kërkuar në funksion të projekteve të identifikuar për zbatim brenda tavaneve buxhetore të përcaktuara. Në këto kushte, shuma e përgjithshme e shpenzimeve e planifikuar, për sistemin e drejtësisë, në buxhetin e shtetit për vitin 2011 është 650 milionë lekë, nga të cilat për shpenzimet operative parashikohen që 90% e tyre të mbulojë sistemin penitenciar.

Nga ana tjetër, burimet njerëzore janë, gjithashtu, të rëndësishme. Burimet njerëzore dhe kapacitetet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të agjencive ekzekutive të sistemit të drejtësisë janë pjesë integrale e sistemit administrative të pushtetit ekzekutiv. Nevojat infrastrukturore dhe financiare dhe pengesat në funksionimin e administratës publike, në tërësi, adresohen në Strategjinë Ndërsëktorale të Reformës së Administratës Publike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1017, datë 12.8.2009 dhe në planin e veprimit të saj, zbatimi i të cilave ka filluar dhe monitorohet vijimisht nga Departamenti i Administratës Publike. Aktualisht po kryhet një punë intensive për reformimin e administratës publike. Kjo reformë është e pritshme të përmirësojë nivelin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Lidhur me burimet njerëzore në gjykata, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, është miratuar dekreti i Presidentit të Republikës nr.6265, datë 16.9.2009 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit”. Në përcaktimin e numrit për çdo gjykatë rrethi dhe apeli, Ministria e Drejtësisë është bazuar në analizën e sistemit gjyqësor të zhvilluar për tre vitet 2005, 2006 dhe 2007; llojin e gjykatave, masën e tyre, numrin e çështjeve, llojin e çështjeve; në sugjerimet e ekspertëve të Misionit Euroalians II, për masën mesatare të ngarkesës që çdo gjyqtar mund të përballojë, si dhe nevojat për mbështetjen e Shkollës së Magjistraturës.

Në përfundim, edhe pse Programi Buxhetor Afatmesëm aktualisht mbulon periudhën 2011-2013 dhe objektivat madhorë që kjo draft strategji parashtron e kapërcejnë këtë periudhë kohore, mbetet përparësi diskutimi me Ministrinë e Financave dhe Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) përcaktimi i taveve të nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj strategjie. Përveç fondeve buxhetore, vijimi i bashkëpunimit të nisur me Bashkimin Europian në kuadër të programit indikativ shumëvjeçar do të synojë thithjen e sa më shumë projekteve në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, objektivi për anëtarësimin e shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe më konkretisht marrja e statusit të vendit kandidat do të lejojë thithjen e shumë më tepër projekteve, pasi dhe fusha e nënkomponentëve do të zgjerohet.

KAPITULLI V LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave, çdo 3 mujor paraqitet analiza e treguesve të monitorimit nga çdo program, pjesë përbërëse e Ministrisë së Drejtësisë. Kjo analizë vlerëson ecurinë e arritjes së objektivave dhe qëllimeve të strategjisë sektoriale, duke identifikuar realizimin në terma sasiorë dhe në vlerë të produkteve të parashikuara, shmangiet nga parashikimet e periudhave dhe shkaqet kryesore të mosrealizimeve.

Mekanizmi institucional për monitorimin e kësaj strategjie do të sigurohet nëpërmjet ngritjes së një strukture të posaçme, në përbërje të së cilës do të jenë:

- Zëvendësministri i Drejtësisë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë;
- 2 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Financave;
- 1 përfaqësues nga DEBASKON;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
- 1 përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese;
- 1 përfaqësues nga Gjykata e Lartë;
- 1 përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
- 1 përfaqësues nga Zyra e Administrimit të Buxhetit;
- 1 përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës;
- 1 përfaqësues nga Avokati i Popullit;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Gjyqtarëve;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Prokurorëve.

Gjithashtu, ftohen sipas çështjeve që monitorohen përfaqësues të shoqërisë civile. Mekanizmi institucional për monitorimin e strategjisë do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë, e cila mban përgjegjësinë për grumbullimin e raportimit të veçantë nga secili institucion, nivelin e përmbushjes së çdo politike dhe aktiviteti në zbatim të saj, problematikat e hasura dhe vlerësimin e ecurisë së strategjisë në tërësi. Mekanizmi do të vendosë vijimësisht masat korrektuese, institucionin përgjegjës për korrektimin dhe sanksionin përkatës. Për këtë qëllim mekanizmi do të analizojë për çdo aktivitet indikatorët e realizimit si raportet e vlerësimit, rekomandimet, pyetësorët e plotësuar, pasojat e ardhura.

Produktet kryesore, rezultat i objektivave të parashikuara, bazuar edhe në dokumentacionin e PBA 2011 – 2013, të grupuara sipas programeve të Ministrisë së Drejtësisë, janë:

- Mirëmenaxhimi i Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet menaxhimit të lartë, të shërbimeve financiare, burimeve njerëzore, auditimit të brendshëm dhe sigurimit të shërbimeve të përgjithshme të stafit.
- Përmirësimi dhe përgatitja e akteve ligjore, përputhja me standardet e KE-së, konsulencë dhe oponencë ligjore.
- Përkthime në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.
- Dosje të përpunuara për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë.
- Asistencë juridike dhe këshillim për veprimtarinë juridike të organeve të administratës shtetërore dhe enteve.
- Përfaqësimi në gjykata, në mbrojtje të interesave pasurore të shtetit shqiptar në gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Inspektimi në Gjyqësor, në Prokurori dhe në Administrativ.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit ICMIS, për përmirësimin e lidhjeve online të sistemit të gjyqësorit me Ministrinë e Drejtësisë.
- Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit.
- Botimi i Fletores Zyrtare dhe botimeve të tjera.
- Publikimi në internet i botimeve të QPZ.
- Ekspertiza mjeko-ligjore, analiza e rasteve të autopsisë, nga ekspertë të mjekësisë ligjore.
- Digjitalizimi i dhomës së autopsisë dhe sektorëve të laboratorit, për ruajtjen dhe arkivimin e veprimtarisë mjeko-ligjore.
- Ulja e mbipopullimit në burgje
- Forcimi i elementeve të sigurisë, nëpërmjet futjes së teknologjive të reja të komunikimit, survejimit, sisteme ndërlidhjeje, etj.
- Trajtimi ushqimor me normë të miratuar ditore, sipas kategorive të dënuar të papunësuar dhe të mitur; të dënuar të punësuar; të dënuar të sëmurë.
- Punësimi i të dënuarve, me synim rehabilitimin e tyre dhe përgatitjen për riintegrimin pas vuajtjes së dënimit.
- Aplikimi i programeve rehabilituese, për trajtimin individual të dënuarve dhe p/burgosurve.
- Mirëfunksionimi i përgjithshëm i sistemit të burgjeve, nëpërmjet drejtimit me efikasitet të stafit dhe fondeve të akorduara.
- Ulja e nivelit të akteve korruptive.
- Rritja e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit, nëpërmjet rritjes së numrit të inspektimeve, auditimeve dhe kualifikimit profesional (trajnimet).
- Modernizimi i sistemit të komunikimit, nëpërmjet shërbimit IT.
- Ndërtimi i 3 burgjeve të reja, në Elbasan, Fier dhe Berat, me financim të huaj, detyrimi i buxhetit të shtetit, sipas kontratave të nënshkruara.
- Pajisje për sistemin e burgjeve, për rritjen e masave të sigurisë, mbrojtjen e trupës policore dhe ruajtjen e burgjeve.
- Furnizimi me automjete, pajisje shëndetësore, sisteme rrufepritëse.
- Sisteme kamerizimi në burgje, për rritjen e sigurisë.
- Mbrojtje perimetrike, bllokues celularësh.
- Rikonstruksione të burgjeve dhe rrjeteve elektrike, ujësjellësi, për krijimin e kushteve optimale të mbajtjes së të dënuarve, në përputhje me standardet europiane.
- Ndërtim i një burgu të ri në ambientet e paraburgimit 313.
- Ndërtim i një burgu të ri për gra në ambientet e burgut 325.
- Trajtim i të dënuarve me shërbim shëndetësor, materiale mjekësore dhe stomatologjike.
- Ofrimi i shërbimit të gjendjes gjyqësore, për institucionet shtetërore dhe subjektet private.
- Komunikim nëpërmjet shërbimit të ndërlidhjes, brenda institucioneve dhe gjatë lëvizjes së të dënuarve.
- Trajtim i të dënuarve me shërbim psiko-social dhe edukativ.
- Birësim i 50 fëmijëve çdo vit, sistemim i fëmijëve në familje brenda dhe jashtë vendit.
- Përmirësimi i dispozitave ligjore për procedurat e birësimeve, vendosja e standardeve.

- Ekzekutimi i titujve ekzekutivë nga zyrat përmbarimore në Tiranë dhe qarqe.
 - Rritja e numrit të ekzekutimeve të titujve ekzekutivë në masën 10%.
 - Përmirësimi i performancës të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, nëpërmjet shqyrtimit në kohë të çështjeve për ekzekutim.
 - Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit *on line* të menaxhimit të çështjeve përmbarimore.
 - Sigurimi i ambienteve të reja për zyrat përmbarimore në rrethe.
 - Rritja e cilësisë së shërbimit nëpërmjet rritjes profesionale të punonjësve, nëpërmjet trajnimeve, motivimit dhe forcimit të kapaciteteve në administratë në konkurrence me Shërbimin Përmbarimor Privat.
 - Krijimi i sistemit të automatizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me bazë të dhënash digjitale të përditësuara.
 - Përmirësimi i shërbimeve të përgjithshme të zyrave vendore, për regjistrimin e pasurive dhe kalimin e pronësisë.
 - Përmirësimi i kushteve të punës në zyrat vendore, nëpërmjet rikonstruksioneve dhe pajisjeve bashkëkohore.
 - Kryerja e shërbimeve ndaj klientëve, nëpërmjet dhënies së informacionit mbi pasuritë e paluajtshme, mbi regjistrimin fillestar.
 - Sigurimi fizik i ambienteve dhe arkivave të dokumentacionit tekniko-ligjor, nëpërmjet shërbimit të mbrojtjes kundër zjarrit.
 - Kryerja e veprimeve të nevojshme në zbatim të legjislacionit në fuqi, për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara, për realizimin e të drejtës së kompensimit.
 - Krijimi dhe administrimi i fondit special të kompensimit të pronave, sipas procedurave të tjetërsimit të oborreve në përdorim dhe sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta.
 - Kompletimi i Agjencisë së Kthimit e Kompensimit të Pronave, me pajisje bashkëkohore.
 - Monitorimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimeve procedurale dhe afateve kohore, për çdo kërkesë për njohje, kthim dhe kompensim të pronës.
 - Verifikim dhe evidentim i të gjithë pasurisë pronë shtetërore, që do të përdoret për kryerjen e kompensimit të pronarëve.
 - Mbikëqyrja e të dënuarve me dënim alternativ, shqyrtimi i kërkesave, vlerësimet, përfaqësimi në gjykata.
 - Kompletimi me pajisje pune bashkëkohore, për punonjësit e Zyrave të Shërbimit të Provës.
- Një analizë vlerësuese e performancës së rezultateve të punës, në fund të çdo 3-mujori, paraqitet në Ministrinë e Financave. Krahas raporteve në formatet *excel*, të dhënat hidhen edhe në *software*, për periudhat përkatëse 3-mujore.
- Gjithashtu, një ndihmesë e lartë merret nga asistenca teknike ndërkombëtare, e ofruar për procesin e monitorimit gjatë fazës së tretë, me qëllim që të rritet cilësia e monitorimit të performancës së produkteve, sipas kërkesave që parashtron ky proces.

PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Nr.	Objektivat specifikë	Veprimet që duhen ndërmarrë	Koha e realizimit	Burimet/ buxheti 000/lekë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues		
1. <i>Objektivi strategjik: Konsolidimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe i organeve të sistemit të drejtësisë në drejtimin strukturor, funksional dhe financiar, si dhe konsolidimi i dialogut ndër-institucional dhe bashkëpunimit (shumë i rëndësishëm)</i>								
1.1	Lehtësimi i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor dhe rritja e aftësisë së tij për të ndikuar te dy pushtetet e tjera (shumë i rëndësishëm)	Zbatimi efektiv i funksioneve të KGJK-së dhe i komisioneve të saj, sidomos për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së	2011-2013 (i vazhdueshëm)	Shpenzime operative	MD; GJL; KLD; Shoqatat e Gjyqtarëve	Kontribut specifik i KGJK-së		
		Përmirësimi i dialogut ndër-institucional dhe bashkëpunimit nëpërmjet kontributit të KGJK-së.	2011-2013 (i vazhdueshëm)				KGJK	
1.2	Forcimi i kontributit të KLD-së në funksionimin e pushtetit gjyqësor, për një drejtësi të pavarur, transparente, efikase e me besim tek publiku, si dhe për të garantuar ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të tij (shumë i rëndësishëm)	Analizë për anëtarësim me kohë të plotë të anëtarëve të KLD-së	6-mujori i parë i 2012-ës	Shpenzime operative	MD; GJL; KLD; Subjekte të interesuara	Nxjerrja e rekomandimeve		
		Rekrutimi i punonjësve cilësorë profesionalisht dhe me integritet të lartë në stafin e KLD	2011 - 2013 (i vazhdueshëm)				KLD	Përmirësimi i performancës së procesit administrativ
		Integrimi i mekanizmeve ligjore për implementimin e kuotës 30% për përfshirjen gjinore	2011				KLD, UNIFEM	Përfaqësimi me 30% i të emëruarave femra
		Përmirësimi i rregullores së inspektoratit sipas standardeve europiane	6-mujori i parë i 2012-ës				KLD, URALIUS III	Hyrja në fuqi e rregullores
		Zgjerimi i Qendrës së Dokumentimit për Praktikën e GJEDNJ-së	2013				KLD	Akses më i mirë në jurisprudencë
1.3	Përmirësimi strukturor i Gjykatës së Lartë për rritjen e ndikimit, autoritetit dhe integritetit të saj (shumë i rëndësishëm)	Analizë për vazhdimin e detyrës së gjyqtarëve të lartë deri në zëvendësimin e tyre	6-mujori i parë i 2012-ës	Shpenzime operative	MD, GJL, EURALIUS III, UNIFEM, dhe subjekte të tjera të interesuara	Nxjerrja e rekomandimeve		
		Reflektimi i gjykatave të specializuara në Kolegjet e Gjykatës së Lartë	2013				Rritja e cilësisë së gjykimeve	
		Shndërrimi i Gjykatës së Lartë në gjykatë karriere	2013					
		Përmirësimi i kriterëve dhe procedurave për emërimin e anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës së Lartë	2013				Rritja e numrit të gjyqtarëve të emëruar sipas kriterëve dhe procedurave të reja	
		Përmirësimi i statusit të gjyqtarëve të lartë	2013					
		Përmirësimin e procedurave të gjyqimit në Gjykatën e Lartë, sidomos të shqyrtimit paraprak dhe evitimin e konfliktit të interesit sipas GJEDNJ-së	6-mujori i parë i 2012-ës				Ulja e kohëzgjatjes së gjyqimit në Gjykatën e Lartë	
		Integrimi i mekanizmeve ligjorë për implementimin e kuotës 30% për përfshirjen gjinore	2011				Përfaqësimi me 30% i gjyqtarëve femra të	

Nr.	Objektivat specifikë	Veprimet që duhen ndërmarrë	Koha e realizimit	Burimet/ buxheti 000/lekë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
						emëruara
		Thellimi i studimeve dhe i botimeve në Gjykatën e Lartë që ndihmojnë veprimtarinë unifikuese	2013			Nxjerrja e publikimeve të reja
1.4	Profilizimi i mëtejshëm i gjykatave në dhënien e drejtësisë (i rëndësishëm)	Vënia në funksionim e Gjykatës Administrative	Varet nga miratimi i ligjit	Shpenzime operative	MD, KLD, ZABGJ	Rritje e cilësisë së drejtësisë
		Vënia në funksionim e Gjykatës Tregtare	Varet nga miratimi i ligjit			
1.5	Rritja e kapaciteteve menaxhuese të sistemit të drejtësisë (i rëndësishëm)	Trajnimi i kryetarëve të gjykatave dhe kancelarëve të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe i administratës gjyqësore	2011 – 2013 (i vazhdueshëm)	Shpenzime të planifikuara nga projektet e USAID dhe EURALIUS 3	MD; SHM; USAID; EURALIUS	Pyetësorët e vlerësimit të sesioneve trajnuese
		Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për administratën gjyqësore” për përfshirjen progresive të administratës në shërbimin civil	6-mujori i dytë i 2011-ës	Shpenzime operative	MD, EURALIUS III	Hyrja në fuqi e ligjit
		Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të ligjit “Për administratën gjyqësore”	6-mujori i parë pas aprovimit të ligjit			Hyrja në fuqi e akteve nënligjore
1.6	Administrimi i pavarur i buxhetit gjyqësor duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinsitucional dhe siguruar skemë funksionale (shumë i rëndësishëm)	Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri të ZABGJ-së	2011	Shpenzime operative	MD	Hyrja në fuqi e ligjit
		Hartimi i projektbuxheteve vjetore në bashkëpunim me aktorët e tjerë të drejtësisë	2011 - 2013		ZABGJ dhe subjektet e interesuara	Përmirësimi i efikasitetit të administrimit të fondeve
		Zbatimi efektiv i legjislacionit për administrimin e pavarur të fondeve të gjykatave, si dhe për auditimin e fondeve publike	2011 – 2013 (i vazhdueshëm)			
1.7	Garantimin e standardeve kushtetuese përmes rritjes së efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese (shumë i rëndësishëm)	Hartimi dhe miratimi i ligjit ndryshues “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”	6-mujori i parë i 2011-ës	Shpenzime operative	MD; GJK; EURALIUS	Hyrja në fuqi e ligjit
		Përmirësimi i kriterëve dhe procedurave për emërimin e anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese	2013			Rritja e numrit të gjyqtarëve të emëruar sipas kriterëve dhe procedurave të reja
		Përmirësimi i statusit të gjyqtarëve kushtetues	2013			Ulja e kohëzgjatjes së gjykimit kushtetues
		Përmirësimi i procedurave të gjykimit kushtetues, sidomos të shqyrtimit paraprak	6-mujori i parë i 2012-ës			Përfaqësimi me 30% i gjyqtarëve femra të emëruara
		Integrimi i mekanizmave ligjorë për implementimin e kuotës 30% për përfshirjen gjinore	2011			
2. <i>Objektivi strategjik: Konsolidimi i përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë për të qenë i pandikuar, i paanshëm dhe konsistent në sigurimin e mbrojtjes ligjore të barabartë për të gjitha palët, si dhe për të qenë i gatshëm për të reaguar ndaj nevojave në ndryshim të komunitetit në kohë dhe në cilësi (shumë i rëndësishëm)</i>						
2.1	Përmirësimi i statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe zbatimi	Rishikimi/plotësimi i kuadrit ligjor mbi imunitetin dhe motivimin financiar të gjyqtarëve të rretheve	2011	Shpenzime operative	MD, KLD, PP, MF	Hyrja në fuqi e ligjit dhe e akteve nënligjore

Nr.	Objektivat specifikë	Veprimet që duhen ndërmarrë	Koha e realizimit	Burimet/ buxheti 000/lekë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
	efikas i legjislationit lidhur me: - Pagën; - Imunitetin; - Emërimin; - Promovimin; - Procedimin disiplinor; - Vlerësimin profesional; - Barazinë gjinore. (shumë i rëndësishëm)	gjqësore dhe të apelit				
		Rishikimi i kuadrit ligjor për çështjen e strukturave organike dhe sistemit të pagave të institucioneve buxhetore	2011		MF, MD, PP	
		Rishikimi i vendimit të KLD-së “Për procedimin disiplinor”	Shtator 2011		KLD, Misioni EURALIUS, shoqatat e gjyqtarëve	
		Zbatimi i rregullores “Për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve”	2011		PP	
